

Vendim: Nr. 01/08/16.006

Data: 01.08.2016

POLITIKA E VLERËSIMIT, TESTIMIT DHE RI-TESTIMIT

Politika e vlerësimit, testimit dhe ritestimit të studentëve të shkollës Cactus Education është si më poshtë:

- Vlerësimi i studentit

1. CE përdor vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve gjatë gjithë kursit/programit të studimit.
2. CE mbështetë pavarësinë akademike duke u dhënë instruktorëve autoritetin për të hartuar kritere vlerësimi specifike për kursin që ata japin, brenda udhëzimeve të dhëna nga CE.
3. Kriteret e vlerësimit duhet të specifikohen në secilin syllabus të kursit. Syllabusi, përfshirë kriteret e vlerësimit, është detyruar për të dy, instruktorin dhe studentin.
4. Çdo test dhe provim, duke përfshirë provimin final, nuk mund të ketë peshë më shumë se 40% të vlerësimit të tërësishtëm.
5. Të gjitha testet dhe provimet, duke përfshirë ato finale, dorëzimi i detyrave dhe projekteve, si dhe komunikimi i vlerësimit të studentit, duke përfshirë vlerësimin final, përfundojnë më së largu në ditën e fundit të semestrit.
6. Provimet nuk përsëriten, nuk ka ri-provime ose ri-vlerësime.
7. Nuk ka afate shtesë të provimeve, duke përfshirë ato finale.
8. Datat e provimeve janë të përcaktuara paraprakisht dhe janë në syllabusin e secilës lëndë.
9. Datat e provimeve nuk mund të ndryshojnë nga datat e dhëna në syllabus, përveç në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikueshme.
10. Në rast të ndryshimit të datës së provimit, njoftimi për ndryshim duhet të shpallet paraprakisht, e më së voni një javë para datës sëmbajtjes së provimit të paraparë fillimisht.
11. Kërkesat e vonuara për të ri-hyrë/ndryshim të datës së provimit, të dorëzuara te mësimdhënësi pasi që provimi është mbajtur ose pasi që semestri ka përfunduar, nuk mirren parasysh.
12. Data e provimeve mund të ndryshohet për studentët mbi baza individuale dhe në rrethana të justifikueshme, atëherë kur:
 - a. Kërkesa për të ndryshuar/rimarrë provimin është paraqitur nga studenti shumë përpara orarit të rregullt të provimi;
 - b. Kërkesa është shoqëruar me një arsyetim me shkrim se pse studenti nuk është në gjendje të hyjë në provim në orarin e rregullt.



- c. Kërkesa e studentit është shqyrtuar nga ekzaminuesi, i cili më pas në rast të shqyrtimit pozitiv, e përcjell kërkesën së bashku me rekomandimin e tij/saj për ndryshimin e orarit të provimit në Këshillin e departamentit për miratim ose Drejtorit/Deakanit.
 - d. Të gjitha tarifat e zbatueshme për hyrjen me vonesë në provime, ose për ri-provime, duke përfshirë ri-dorëzimin e punimeve me shkrim për vlerësim, janë paguar nga studenti.
13. Vendimin për ndryshimin e datës së provimit mund të marrë Këshilli i departamentit ose Drejtori/Dekani, me rekomandim të mësimdhënësit të lëndës.
14. Studentët që nuk akumulojnë rezultate për të kaluar me sukses lëndën duhet të marrin përsëri të njejtën lëndë prej fillimit në semestrin e ardhshëm kur kjo lëndë ofrohet.

- Vonesat në dorëzimin e detyrave dhe projekteve

Vonesat në dorëzimin e detyrave dhe projekteve, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe në syllabusin e lëndës, mund të tolerohen në diskrecion të mësimdhënësit, si më poshtë:

Vonesat në dorëzim të detyrave dhe projekteve penalizohen:

1. një ditë vonesë penalizohet 10%,
2. dy ditë vonesë penalizohet 20%.
3. Vonesat në dorëzim prej tri ditëve e më shumë - nuk janë të pranueshme, përveç në raste të jashtëzakonshme të arsyetuara nga studenti. Këto raste përfshijnë pamundësinë e studentit për të lajmëruar paraprakisht, si sëmundjen, e që duhet të jetë e vërtetuar nga raporti mjekësor, fatkeqësitë natyrore ose arsye të tjera që pamundësojnë studentin të lajmërojë paraprakisht për vonesën.

- Nota përfundimtare

Nota përfundimtare jepet në bazë të përqindjes së rezultateve kumulative të studentit, si më poshtë:

Rezultati	Nota
91 - 100%	A ose 10
81 - 90%	B ose 9
71 - 80%	C ose 8
61 - 70%	D ose 7
51 - 60%	E ose 6
0 - 50%	F ose 5

Nota e marrë do të figurojë në certifikatën e studentit për atë lëndë. Studentit do t'i lëshohet certifikatë nga lënda nëse ka marrë notën përfundimtare A, B, C, D, ose E.

Nota F është e pakalueshme. Studentit që ka marrë notën përfundimtare F nuk i lëshohet certifikatë nga lënda.



- E drejta për ankesë ndaj vlerësimit të studentit dhe procedura e ankesës

Procedura e apelit të vlerësimit të studentit ka për qëllim të sigurojë një gjurmë të dokumentuar të procesit dhe të regjistrohet qartë me informacion të detajuar konciz në secilën fazë.

1. Studenti ka të drejtë të parashtojë ankesë në lidhje me vlerësimin që ka marrë në lëndë, nëse konsideron se vlerësimi i është bërë jo në pajtim me mënyrën e vlerësimit të dhënë në syllabusin e lëndës, me rregulloret e CE ose me Statutin e CE.
2. Ankesa me shkrim në lidhje me vlerësimin në lëndë parashtrohet te Dekani/Prodekani për mësim brenda 36 orëve nga komunikimi i notës. Dekani/Prodekani për mësim merr vendim në lidhje me ankesën e studentit brenda 24 orëve.
3. Nëse ankesa konsiderohet e bazuar, studentit i jepet e drejta për të hyrë në ri-vlerësim para Komisionit për vlerësim, brenda 3 ditëve nga parashtrimi i ankesës.
4. Komisioni për vlerësim emërohet nga Dekani/Prodekani për mësim dhe përbëhet nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve është mësimdhënësi i lëndës ose udhëheqësi i lëndës në department. Komisioni merr vendim brenda 24 orëve nga dita e ri-vlerësimit të studentit.
5. Studenti mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të Komisionit për vlerësim në shkallën e dytë te Komisioni i ankesave të CE. Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar dhe nuk mund të apelohe më tutje.

- Provimet për njohjen e mësimi paraprak

Provimet për njohjen e mësimi paraprak, organizohen dhe mbahen në raste individuale, në tërësi sipas udhëzimeve dhe rregullativës ligjore në fuqi.

Kjo politikë hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në sjelljen e një vendimi për ndryshimin e saj.

Drejtori i shkollës

Kastriot Fazliu

